



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 3377 Prot.

Tiranë, më 02.05 2024

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 41, datë 02.05 2024

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/b të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" (në vijim "LPP"), i ndryshuar (në fuqi në kohën e nisjes së procedimit administrativ), në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Dumreja – 2" Shpk, me NUIS L13521202F, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në realizimin e plotë të kontratës Nr. 1/58 Prot., datë 29.03.2021, me objekt: "Transporti i punonjësve të IEVP Lushnje", të lidhur me Institucionin e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Lushnje.

APP i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë dhe për zbatim të nenit 23 të LPP.

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Dumreja – 2" Shpk, me NUIS L13521202F, me adresë: "Lagja "Dyli Haxhire", Rruga "Demir Sulçebe", Nr. 323, Elbasan.

I. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Dumreja – 2" Shpk, ka nisur për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, sipas parashikimeve të nenit 78/1/b të LPP (në fuqi në kohën e nisjes së procedimit administrativ), në të cilin përcaktohet se: "1. Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike, për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: b) mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, që kanë ndodhur për faj të operatorit ekonomik".

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 41, datë 02.05 2024, APP ka vendosur të përjashtojë operatorin ekonomik "Dumreja – 2" Shpk, me NUIS L13521202F, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për 6 (gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.